



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 11881/1 Prot.

Tiranë, më 06.12. 2018

URDHËR

NR. 797, DATË 06.12. 2018

PËR
MIRATIMIN E PROGRAMEVE ORIENTUESE TË MATURËS SHTETËRORE
2019 PËR SHKOLLAT ARTISTIKE DHE SPORTIVE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 25 dhe 26 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e programeve orientuese të provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore 2019 për shkollat artistike dhe sportive, të lëndëve:
 - Gjuhë e huaj (Faqe 1-18)
 - Gjuhë shqipe dhe letërsi (Faqe 1-17)
 - Matematikë bërthamë (Faqe 1-17)
2. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.
3. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Lindita Nikolla





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN KOMBËTAR PËR MATURËN
SHTETËRORE
PËR SHKOLLAT ARTISTIKE DHE SPORTIVE**

LËNDA : GJUHË E HUAJ

VITI SHKOLLOR 2018-2019

Tiranë tetor 2018

PËRMBAJTJA

I.	HYRJE	3
II.	UDHËZIME PRAKTIKE MBI PËRDORIMIN E PROGRAMIT	4
III.	STRUKTURA E TESTIT	5
IV.	REZULTATET E TË NXËNIT PËR SECILËN AFTËSI	6
V.	TIPET E USHTRIMEVE TË REKOMANDUARA	7
VI.	PËRMBAJTJA E PROGRAMIT	9

I. HYRJE

Programi orientues për përgatitjen e provimeve të maturës shtetërore për lëndën gjuhë e huaj vjen si sintezë e njohurive dhe shprehive të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë.

Hartimi i këtij programi orientues është bazuar tërësisht në dokumentet kurrikulare për lëndën “Gjuhë e huaj” duke pasur parasysh zhvillimin e aftësive gjuhësore që do të testohen si dhe programet viteve të mëparshme.

Ky program orientues synon:

- të ndihmojë nxënësit në përgatitjen e tyre për provimin e Maturës Shtetërore në lëndën gjuhë e huaj duke ju referuar referuar programit të gjuhës së huaj të parë , si edhe Kuadrit Europiane të Referencave për Gjuhët.
- të ndihmojë mësuesin e lëndës për t’u dhënë orientimet e duhura nxënësve dhe për të punuar për zbatimin e programit.
- vlerësimin e njëkohshëm të 2 aftësive kryesore (nga katër aftësi që ka gjuha e huaj) që përbëjnë dhe ***dy konceptet bazë***, që janë *të kuptuarit dhe të shprehurit me shkrim*.
- të japë orientime për mësuesit hartues të testeve të provimit të maturës shtetërore për gjuhën e huaj të parë.
- vlerësimin e të kuptuarit dhe të shprehurit duke mbajtur parasysh formimin e njohurive dhe shprehive të domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale si dhe arritjen e rezultateve të të nxënit për nivelin përkatës në zbatim të kurrikulës me kompetenca të lëndës së gjuhës së huaj.
- aftësinë për të përdorur formimin gjuhësor në mënyrë të pavarur, korrekte dhe të përshtatshme me situata komunikimi të dhëna.

Bazuar në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore, testi i gjuhës së huaj hartohet në përputhje me gjuhën, e cila në planin mësimor trajtohet si gjuhë e huaj e parë dhe niveli i njohurive synohet të jetë B1, sipas “Kuadrit të Përbashkët European i Referencave për Gjuhët”.

Më poshtë jepet përshkrimi i nivelit B1 i cili i referohet shkallës globale të “Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët”.

Përdorues i pavarur	B1	<i>Nxënësi:</i> <i>Mund të kuptojë çështjet kryesore të një informacioni standard të qartë për çështje të njohura që hasen rregullisht në shkollë, punë, argëtim etj.</i> <i>Mund t'ia dalë në situata të shfaqura gjatë një udhëtimi në vende ku flitet gjuha që mëson.</i> <i>Mund të prodhojë material të thjeshtë për tema të njohura ose të një fushe të interesit personal.</i> <i>Mund të përshkruajë përvoja dhe ngjarje, ëndrra, shpresa dhe ambicje dhe shkurtimisht jep arsye dhe shpjegime për opinionet dhe planet.</i>
----------------------------	-----------	---

II. UDHËZIME PRAKTIKE MBI PËRDORIMIN E PROGRAMIT

Për përdorimin e këtij programi mësuesi duhet të ketë parasysh specifikën e gjuhës së huaj, pasi nxënësi në provim do të përballlet me pjesë të reja leximi, megjithëse tematika, gramatika dhe funksionet gjuhësore do të jenë po ato që ka studiuar ndër vite.

Kur flitet për tematikën kryesore në program, nxënësit duhet të kenë njohuri për temat që janë të përfshira në program nga **jeta e përditshme, bota e shkollës dhe e punës, jeta personale dhe shoqërore, bota rreth nesh, bota e komunikimit etj.**

Për sa i përket gramatikës, mësuesi duhet t'i përgatisë nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin ushtrime mbi aspektet kryesore gramatikore të studjuara gjatë shkollimit dhe t'i përdorin ato në mënyrë të pavarur ose dhe në kontekst të një situatë të re.

Mësuesi duhet t'i vërë theksin anës praktike të trajtimit të strukturave gramatikore nëpërmjet ushtrimeve të shumëllojshme të dhëna në tekstin shkollor, fletoren e punës dhe më gjerë.

Funksionet gjuhësore duhet të trajtohen në mënyrë sa më të larmishme duke përdorur situata nga të gjitha fushat e jetës të cilat trajtohen në nivelin B1.

Për sa i përket të shkruarit, mësuesi duhet të ushtrojë nxënësit të jenë të aftë të përmbushin kërkesat e nivelit përkatës gjuhësor përmes të shkruarit të një letre/e-mail formale, eseje, raporti , prezantimi, permbledhje artikujsh deri në argumentim material.

III. STRUKTURA E TESTIT

Testi i gjuhës së huaj ndërtohet mbi bazën e dy aftësive dhe vlerësimin e njëkohshëm të tyre që janë të kuptuarit dhe të shprehurit me shkrim.

Nëpërmjet testit të lëndës “Gjuhë e huaj” në Provimin e Maturës Shtetërore, nxënësi do të vlerësoshet për realizimin e kompetencave gjuhësore.

KOMPETENCAT E LËNDËS “GJUHË E HUAJ”	PËRSHKRIMI I KOMPETENCAVE
Kompetenca gjuhësore	Nxënësi • zotëron fjalor të mjaftueshëm për të përshkruar situata të njohura dhe të pa parashikuara, shpjegon me saktësi por ndonjëherë edhe me hezitim pikat kryesore të një problemi duke përdorur edhe fjali të përbëra. • ka fjalor të mjaftueshëm për t’u shprehur rreth fushave të tij të interesit si familja, interesat, dëshirat, udhëtimet, puna dhe ngjarjet aktuale. • demonstroi saktësi leksikore relativisht të lartë por akoma bën gabime kur shpreh mendime mbi situata të vështira dhe të panjohura për të. • tregon relativisht një shkallë të lartë kontrolli dhe komunikoi me saktësi gramatikore në kontekste të njohura si edhe nuk bën gabime që të çojnë në keqkuptime të asaj që do të shprehë, ndonjëherë mund të ndikohet nga gjuha amëtare. • është i qartë në të folur dhe në shqiptimin e fjalëve megjithëse ka raste të pakta kur shqiptimi nuk është i saktë. • krijon tekste të gjata dhe shkruan pothuajse pa gabime dhe është i saktë në përdorimin e shenjave të pikësimit pavarësisht se ndonjëherë mund të tregojë ndikime të gjuhës amëtare.
Kompetenca Socio-gjuhësore	• kryen dhe ju përgjigjet një game të gjerë funksionesh gjuhësore duke përdorur shprehjet e zakonshme të një regjistri neutral. • njeh rregullat e mirësjelljes dhe vepron në mënyrë të përshtatshme me to. • shprehet qartë në situata të ndryshme dhe shmang gabimet në formulimin e ideve. • njeh mirë ndryshimet midis kulturave, qëndrimeve, vlerave dhe besimeve

	që mbizotërojnë në vendin e tij dhe në vendet ku flitet gjuha e huaj. • përshtat shprehjet e mësuara për t'i përdorur në situatë më pak të njohura dhe të vështira për të.
Kompetenca pragmatike	• ndërhyr dhe merr fjalën në një bisedë me temë të njohur për të duke përdorur shprehjet e mësuara. • tregon në mënyrë logjike dhe të rrjedhshme një tregim ose përshkrim në mënyrë lineare por ka raste që përdor argumenta dhe shembuj të tjerë. • lidh pjesë të shkurtra dhe të thjeshta në një tekst të plotë në mënyrë lineare duke tentuar për tekste më të komplikuara.

Përmbushja e kompetencave gjuhësore që një nxënës duhet të zotërojë në përfundim të shkollës së mesme do të testohen sipas tabelës më poshtë:

Aftësitë gjuhësore që do të vlerësohen	Përqindja
Të lexuarit dhe të kuptuarit e një teksti të shkruar	50%
Përdorimi i drejtë i gjuhës (gramatika dhe leksiku)	28%
Të shkruarit	22%

IV. REZULTATET E TË NXËNIT PËR SECILËN AFTËSI

Të lexuarit dhe të kuptuarit e një teksti të shkruar
Nxënësi: • lexon artikuj dhe raporte të ndryshme që kanë lidhje me probleme dhe tema nga fusha e tij të interesit. • kupton pjesë letrare dhe jo-letrare bashkëkohore. • lexon dhe kupton një tekst relativisht shpejt si dhe kupton përmbajtjen dhe gjen thelbin e një informacioni, të një artikulli apo një reportazhi me tema nga fushat e tij të interesit.
Përdorimi i drejtë i gjuhës
Nxënësi: • përcjell mesazhin me shkrim nëpërmjet strukturave të sakta gjuhësore dhe gramatikore dhe pa gabime ortografike;

• përdor mjaftueshëm mirë një repertor të shprehjeve dhe frazave që bashkëngjiten me situata të parashikuara për të. • ka një gamë të mjaftueshme fjalori për tema lidhur me fushën e tij të interesit dhe tema të tjera të përgjithshme. • ndryshon formulimin e fjalive për të shmangur përsëritje të shpeshta, por mangësitë leksikore mund të shkaktojnë ende hezitime dhe përdorime të perifrastave. • ka një kontroll të mirë mbi aspektin gramatikor; bën gabime të rastësishme dhe jo sistematike, bën rrallë gabime sintaksore duke e korrigjuar veten. • duke pasur një kontroll të mirë gramatikor, nuk bën gabime që të çojnë në keqkuptime.
Të shkruarit
Nxënësi • shkruan ese dhe raporte që zhvillojnë një argumentim në mënyrë metodike duke theksuar në mënyrë të përshtatshme pikat e rëndësishme dhe hollësitë e spikatura që e mbështesin atë. • vlerëson idetë e ndryshme ose zgjidhjet e një problemi. • paraqet argumentim pro ose kundër një pikpamjeje të caktuar duke shpjeguar përparësitë ose problemet e opsioneve të ndryshme.

V. TIPET E USHTRIMEVE TË REKOMANDUARA

Të lexuarit dhe të kuptuarit e një teksti të shkruar
Përshkrimi: Vlerësimi i kësaj aftësie do të bëhet mbi bazën e disa teksteve të panjohura me tema aktuale që lidhen me interesat e të rinjve mbi të cilat do të ndërtohen pyetje që do të testojnë aftësinë e nxënësit për të kuptuar një pjesë letrare ose jo letrare apo gjini tjetër e të shkruarit (reklama, informacione, letra, pjesë nga broshura të ndryshme turistike, etj.) Nxënësi duhet të jetë në gjendje të lexojë dhe të kuptojë në mënyrë të përgjithshme – dhe të detajuar informacionin e dhënë në pjesën e leximit, të mbledhë informacionet që i kërkohen rreth tekstit apo të japë një vlerësim ose opinionin e tij të mbështetur mbi fakte në pjesën që lexon.
• pyetje mbi idenë kryesore të tekstit • pyetje mbi kuptimin e përgjithshëm të tekstit • pyetje për të shpjeguar shkakun e një ngjarjeje në tekst • pyetje mbi informacione specifike në tekst • pyetje mbi detaje të ndryshme që dalin në tekst

• pyetje për gjetjen e kuptimit të fjalëve nga konteksti • plotësimi i vendeve bosh me informacionin e duhur • ushtrime me përgjigje <i>po/jo</i> • pyetje të hapura me përgjigje të shkurtër ose të strukturuar mirë. • ushtrime me disa alternativa (përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 alternativat) • vendosja e paragrafëve sipas rendit të duhur në renditjen e ngjarjeve • pyetje për të gjetur nënkuptimin e një fjale ose shprehjeje
Përdorimi i drejtë i gjuhës
Përshkrimi: Njohuritë kryesore që nxënësi ka marrë mbi përdorimin e gjuhës ndër vite, do të testohen përmes ushtrimeve që e shohin gramatikën dhe leksikun si pjesë të integruara në situata të gjuhës së përdorur; pra si një gjuhë funksionale.
• ushtrime me plotësime hapësirash ku nxënësi duhet të vendosë fjalën ose njësine e duhur gramatikore. (Ushtrimi ndërtohet mbi një tekst të shkurtër ose paragraf me një temë të caktuar; gramatika dhe leksiku ndërthuren bashkë në atë çka i kërkohet nxënësit të plotësojë.) • ushtrime me zgjedhje alternativash • ushtrime me plotësime vendesh bosh në dialogje me tema nga jeta e përditshme • ushtrime me plotësime hapësirash ku nxënësi duhet të vendosë fjalën ose njësine e duhur gramatikore. (fjalët që duhet të vendosë nxënësi jepen në një listë. Nga kjo listë ai gjen fjalën ose njësinë e duhur gramatikore për të plotësuar tekstin apo paragrafin në mënyrë që ai të jetë i saktë.) • situata komunikimi me hapësira bosh të cilat duhet të plotësohen nga nxënësi me fjalët e tyre. Nxënësit do t'i duhet ta plotësojë situatën komunikative me fjalë ose struktura gjuhësore që mungojë duke e bërë atë të plotë e me kuptim.
Të shkruarit
Përshkrimi: Nxënësi mund të prodhojë me shkrim një tekst të detajuar rreth temave me subjekte që lidhen me fushën e tij të interesit duke shpjeguar këndvështrimin e tij rreth temës dhe duke dhënë avantazhet dhe disavantazhet e opsioneve të ndryshme që ai rendit në këtë pjesë të shkruar.
• ese • përmbledhje filmi, libri • artikull në gazetën e shkollës • shkrimi i një letre/email formal (aplikim, rekomandim, ankese etj)

VI. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Nxënësit në provim do të përballen me situata ose pjesë të reja leximi por *tematika*, *gramatika* dhe *funksionet gjuhësore* do të jenë ato që nxënësit kanë studiuar për këtë nivel gjuhe .

Tematikat me të cilat do ndeshen në provimin e maturës shtetërore do të përfshijë temat bazë sipas kurrikulës dhe “Kuardit Evropian të Referencave për Gjuhët”.

- **Jeta e përditshme** (*organizimi i një plani ditor dhe i kohës së studimit; kujtime të mrekullueshme- dita më e bukur e jetës sime; qëllimet afatshkurtër dhe afatgjatë; çfarë dua unë për të ardhmen time; etj.*)
- **Bota e shkollës dhe e punës** (*organizimi i një biznesi të vogël; shqetësimet e shoqërisë së sotme si papunësia etj; studimet dhe universitetet në vend dhe në botë; etj.*)
- **Jeta personale dhe shoqërore** (*shanse dhe të drejta të barabarta për gratë dhe burrat, të rinjtë dhe të rriturit; vendlindja; personalitete në shoqëri; etj.*)
- **Bota rreth nesh** (*arti në shekuj; e ardhmja, flora dhe fauna; historia e filmit; programet televizive; zakonet dhe traditat në vendet ku flitet gjuha që po mësohet; momente të rëndësishme të historisë botërore; personalitete në fusha të ndryshme të jetës; etj.*)
- **Bota e komunikimit** (*bota e teknologjisë; rrjetet sociale; të shkruarit e letrave formale dhe jo formale, ese; etj.*)

Gjuhë angleze
• Family and school life • arts(music, picture, sculpture, cinema, celebrities) • sports and entertainments • technology and communication • social networks • travelling and holidays • environmental issue, world issues • modern living, etc. • cultural and education exchanges • healthy eating and healthy attitudes
Gjuhë Frënge
LE MONDE DU TRAVAIL • mes projets d’avenir • les professions.

L'ÉCOLE ET L'ÉDUCATION

- les relations entre les professeurs et les étudiants
- les activités scolaires: culturelles et sportives
- les échanges scolaires; les jumelages.

LES VOYAGES

- les voyages touristiques et les échanges
- les vacances en famille et avec les copains
- les transports.

L'ENVIRONNEMENT

- les paysages; la nature
- la pollution marine; la défense de la planète.

PRATIQUES CULTURELLES

- la vie quotidienne,
- le mode de vie
- les goûts et les préférences
- la mode, la musique etc.

LES RELATIONS INTERPERSONNELLES

- mes amis
- l'amour, la jalousie, la haine
- la surprise, l'indifférence
- les relations conflictuelles
- la force, la faiblesse,
- l'exploit et l'aventure.

CULTURE ET CIVILISATION

- la mode, la publicité
- littérature; la musique; la peinture; les vedettes
- les échanges culturels: les jumelages.

LES MOYENS DE COMMUNICATION

- les médias
- la presse
- la télévision
- le téléphone.

Gjuhë Italiane

- Identificare
- La famiglia
- La scuola e l'educazione
- Lavoro & Business
- Cultura, Civiltà`
- Scienze, Tecnologia
- Vacanze, Viaggi
- La salute
- Shopping
- Cibi e bevande
- Servizi pubblici
- Piante e Animali
- La natura

Gjuhë Gjermane

Erlebnisbereich 'Ich als Person'

- Persönliche Daten, (Lebenslauf)
- Aussehen und Geschmack
- Körper und Gesundheit
- Bekleidung
- Tagesablauf
- Freizeit und Hobbys
- Zukunft
- Abenteuer

Erlebnisbereich 'Unmittelbare Umgebung'

- Familie, Freunde und Bekannte, Nachbarn
- Familie, Familienaufgaben - Rollenverteilung
- Familienfeste und Geschenke
- Essen und Trinken
- Gesunderer Lebensstil und Gesellschaft
- Wohnung, Umzug und Einrichtung

Jugend und ihre Probleme

- Sport und Fitness
- Liebe und Liebeskummer

- Träume und Wünsche
- Auf dem Land /in der Stadt

Erlebnisbereich ‘ Weitere Umgebung’

Fremd(e)

Integration

Emanzipation und Gleichberechtigung

Reisen, Reisegefühle, Reisepläne

- Urlaub, Natur und Landschaft
- Kommunikation
- Länder, Städte, Sprachen

Schule, Schulerfahrungen und Ausbildung

- Arbeitswelt und Karriere
- Beruf, Job und Praktikum
- Konsum und Warenwelt (Kundenwünsche)
- Mobilität
- Technik und Alltag

Vermitteltes Erlebnisbereich

Medien und Werbung

- Nachrichten und Berichte
- Landeskunde und interkulturelles Lernen
- Das eigene Land
- Deutschsprachige Länder
- Aus der Politik und Geschichte
- Wissenschaft und Forschung
- Literatur und Kunst
- Kultur und modernes Leben

Përdorimi i gjuhës do trajtojë gramatikën, leksikun dhe funksionet gjuhësore të Nivelit B1.

Funksionet gjuhësore duhet të trajtohen nëpërmjet ushtrimeve të ndërtuara si bashkëbisedime në situata të ndryshme të jetës së përditshme. Nxënësi duhet të jetë i përgatitur kryesisht për këto situata gjuhësore.

Gjuhë angleze
• Describing places • Describing past experiences and storytelling • Describing feelings, emotions, attitudes • Expressing opinions • Expressing agreement/ disagreement • Talking about films and books
Gjuhë Frënge
• Demander et donner des explications, des informations • Donner et demander un avis, une opinion • P.ex. je pense que, je crois que, il me semble que? • Exprimer son accord ou son désaccord • P.ex. je suis d'accord , je ne partage pas votre avis • Raconter un évènement, exprimer la durée d'une action • P.ex. Depuis..., ça fait... il y a... etc. • Décrire les personnes ou les circonstances d'un évènement • Raconter des actions habituelles ou une suite d'évènements au passé (P.ex. d'habitude..., chaque matin + imparfait d'abord..., après..., à la fin... et.) • Demander et donner des conseils ou des ordres • P.ex. donne- lui son livre! Il ne fallait pas faire cela! Il faut que tu finisses vite! • Exprimer la cause et la conséquence • Indicatif... • Exprimer l'opposition, la concession • Exprimer le but (pour + inf..., pour que + subjonctif) • Comparer, exprimer la ressemblance et la différence (c'est pareil, c'est tout à fait différent, ça change et.) • Exprimer la condition et l'hypothèse • Rapporter les paroles de quelqu'un.
Gjuhë Italiane
• Esprimere interessi • Esprimere preferenze • Permettere e proibire • Dare e chiedere informazioni

- Esprimere opinioni
- Prendere decisioni
- Esprimere possibilita', probabilita' e incertezza
- Confermare

Gjuhë Gjermane

- Eigene Meinungen äussern: meiner Meinung nach...; Ich bin mir sicher dass...; Ich würde sagen ...; usw.
- Vermutungen, Behauptungen formulieren: Ich behaupte...; Ich vermute...; Ich glaube...; Kann sein dass...; Wahrscheinlich...; usw.
- Sich pro und kontra äussern: Ich stimme zu; Ich bin dafür; Ich bin völlig dagegen. usw.
- Über eigene Erfahrungen berichten. Über Ereignisse in der Vergangenheit berichten.
- Die eigene Meinung sagen und Argumente für den eigenen Standpunkt nennen
- Ratschläge geben, um Rat bitten
- Gefallen, Missfallen ausdrücken.
- Vorschläge annehmen und ablehnen
- Gefühle ausdrücken, Wünsche äussern
- Informieren und nachfragen.
- Etwas begründen, etwas beurteilen, etwas bewerten, vergleichen, Verständnis zeigen, erstaunt oder kritisch reagieren.
- Ansichten begründen und verteidigen

Elementet dhe strukturat gramatikore

Për një komunikim të saktë nga ana gramatikore, sugjerohet të punohet në mënyrë të përqendruar mbi strukturat dhe çështjet gramatikore më të rëndësishme të trajtuara.

Gjuhë angleze

- W- and Yes/No Questions in present /past
- Complex question tags
- Past continuous
- Used to
- Would expressing habits in the past
- Past perfect
- Future time (will & going to)
- Future continuous

- Present perfect
- Present perfect vs. past simple
- Present perfect continuous
- Conditionals
- Zero, first and second conditional
- Phrasal Verbs
- Passives
- Simple passive
- Reported speech (range of tenses)
- Modals: Possibility
- Might, may, will, probably
- Must/can't (deduction)
- Modals: Obligation & Necessity
- Must/have to
- Ought to
- Need to
- Modals: Past
- Should have, might have/etc.
- Articles with countable and uncountable nouns
- Determiners
- Broad range (e.g. all the, most, both)
- Collocation of adjectives
- Adverbial phrases of time, place and frequency including word order
- Adjectives vs. adverbs
- Adverbial phrases of degree/extent, probability
- Comparative and superlative form of adverbs
- Broader range of intensifiers

Gjuhë Frënge

Les modes et les temps verbaux

- **L'indicatif des verbes réguliers , irréguliers et des verbes pronominaux**
- (Le présent , / l'imparfait/ le passé composé/ le plus-que-parfait)
- Le futur / le futur antérieur
- Le futur proche / Le passé récent

- Le participe passé et ses accords
- La concordance des temps de l'indicatif

Le conditionnel

- Le conditionnel présent

Le subjonctif

Le subjonctif présent

- La phrase passive et la phrase active
- Le gérondif
- L'impératif
- L'expression de la cause et de la conséquence
- L'expression du but
- L'expression de l'opposition et de la concession.
- Le discours direct / indirect (présent)

Les articulateurs

- Les articulateurs temporels.

Les pronoms et les articles

- Le complément d'objet direct/ indirect
- La place des pronoms: ex. Je le lui donnerai
- Les pronoms: y et en
- Les pronoms relatifs simples
- Les pronoms indéfinis
- Les pronoms et les adjectifs possessifs
- Les pronoms et les adjectifs démonstratifs
- La place, le nombre et le genre des adjectifs qualificatifs
- La nominalisation
- Les prépositions
- Les articles partitifs, définis, indéfinis, contractés

Gjuhë Italiane

- Tempi dell'indicativo (Passato prossimo, Futuro anteriore, Trapassato prossimo,
- Tempi del Congiuntivo
- Pronomi
- Forma passiva
- Condizionale composto

- Gradi dell' aggettivo
- Preposizioni articolate
- Avverbi
- Congiunzioni

Gjuhë Gjermane

- Verb: Präsens
- Perfekt, Präteritum
- Futur I, Plusquamperfekt
- Passiv
- Passiv mit Modalverben
- Konjunktiv II
- Die Umschreibung der K. II mit würde + Infinitiv
- Regelmässige, Unregelmässige Verben
- Trennbare Verben
- Modalverben
- Partizip I
- Unbestimmter, bestimmter Artikel, Negativartikel, Frageartikel
- Substantiv: Singular, Plural
- Deklination des Substantivs
- Genus der Nomen
- Zusammengesetzte Nomen
- Wortbildung
- Adjektiv :Adjektivdeklinaton und Graduierung
- Prädikativ, Attributives Adjektiv
- Adjektiv als Nomen, n- Deklination
- Infinitiv mit zu..., statt zu +Infinitiv,ohne zu + Infinitiv
- Präpositionen mit Akkusativ, Dativ, Genitiv, Wechselpräpositionen
- Präpositionaladverbien
- Verben mit Reflexivpronomen
- Possessivartikel
- Demonstrativartikel: dieser, dieses, diese
- Indefinitpronomen
- Nebensätze: / Kausalsätze

- Temporale Nebensätze
- Konsekutivsätze/ Finalsätze/ Konzessivsätze
- Relativsatz/ Relativpronomen
- Vergleichsätze
- Temporal-Kausal-Modal-Lokangaben
- Verben mit Präpositional-Ergänzungen
- Funktionsverb-Gefüge (Nomen- Verb- Verbindungen)
- Wortbildung: Substantive aus Verben
- Aufforderung und Imperativ
- Konjunktionen
- Direktionaladverbien
- Ordinalzahlen
- Satzklammer
- Zweiteilige Konnektoren
- Partikeln



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN KOMBËTAR PËR MATURËN
SHTETËRORE**

PËR SHKOLLAT ARTISTIKE DHE SPORTIVE

LËNDA : GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

VITI SHKOLLOR 2018-2019

Tiranë tetor 2018

Përmbajtja

1. Hyrje	3
2. Përmbajtja e programit orientues.....	4
3. Përshkrimi i kompetencave gjuhësore dhe letrare	4
Gjuhë shqipe	4
Letërsi	5
4. Pësja e gjuhës shqipe dhe e letërsisë në test	6
5. Struktura e testit.....	7
6. Llojet e pyetjeve/ kërkesave të rekomanduara	7
7. Njohuritë dhe aftësitë sipas kompetencave	8

1. Hyrje

Gjuha shqipe dhe letërsia është një nga tri provimet e detyruara në Maturën Shtetërore. Në këtë provim nxënësit do të zhvillojnë një test të përbashkët për të dyja lëndët: Gjuhë shqipe dhe Letërsi.

Gjuha shqipe dhe Letërsia bëjnë pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Të dyja lëndët synojnë zhvillimin gjuhësor e letrar që është boshti themelor për rritjen intelektuale, shoqërore, estetike dhe emocionale të nxënësve. Më konkretisht, ato i aftësojnë nxënësit që ta përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale, për kënaqësi estetike, për të marrë informacion, si dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës.

Gjuha shqipe

Lënda e gjuhës shqipe ka një rëndësi të veçantë në kurrikulën e arsimit të mesëm të lartë. Nëpërmjet kësaj lënde, nxënësit:

- fitojnë njohuri dhe demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime rreth sistemit gjuhësor të shqipes;
- fitojnë njohuri dhe demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime për të komunikuar në mënyrën e duhur.

Lënda e gjuhës shqipe, gjithashtu, siguron mundësi që nxënësit të ndiejnë fuqinë e gjuhës si një mënyrë për të shprehur përvojat e tyre dhe për të shmangur vështirësitë që ndajnë individët. Duke u mbështetur në studimin e teksteve të ndryshme, programi krijon mundësi që nxënësit të dallojnë dhe të vlerësojnë jo vetëm strukturën dhe karakteristikat e këtyre teksteve, por edhe mesazhet dhe kuptimet e tyre.

Letërsia

Letërsia është një nga lëndët kryesore në arsimin e mesëm të lartë. Ajo ndikon në formimin estetik dhe letrar, në rritjen e aftësive krijuese dhe në pasurimin e aftësive shprehëse të nxënësve. Kjo lëndë, gjithashtu, mundëson krijimin e një raporti pozitiv dhe të qëndrueshëm mes nxënësve dhe letërsisë.

Programi orientues

Programi orientues i gjuhës shqipe dhe i letërsisë, nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë kryesore të mësuara gjatë tri viteve, ka si qëllim të orientojë punën e mësuesit, përgatitjen e nxënësve dhe hartuesit e testit përfundimtar të Maturës Shtetërore.

Ky program është bazuar në programet e gjuhës shqipe dhe të letërsisë në arsimin e mesëm të lartë dhe përfshin njohuritë dhe shkathhtësisë më të rëndësishme që duhet të zotërojnë nxënësit.

2. Përmbajtja e programit orientues

Programi orientues bazohet në parimin se të zotërosh njohuri dhe aftësi gjuhësore dhe letrare do të thotë të jesh në gjendje t'i demonstrosht ato në tekste të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe në situata të jetës së përditshme.

Programi orientues është mbështetur:

- në programet e lëndës së gjuhës shqipe dhe të lëndës së letërsisë, në klasat 10-12;
- në udhëzuesin për zhvillimin e kurrikulës së AML-së;
- në nivelet e arritjes të lëndës së gjuhës shqipe dhe të lëndës së letërsisë.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi përmban:

- strukturën e testit;
- peshën e secilës lëndë në test;
- llojet e pyetjeve ose kërkesave që vlerësojnë kompetencat që zotëron nxënësi;
- njohuritë dhe aftësitë e kompetencave gjuhësore dhe letrare.

3. Përshkrimi i kompetencave gjuhësore dhe letrare

Duke qenë se provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen me shkrim, kompetencat gjuhësore dhe letrare që vlerësohen janë:

- Të lexuarit e teksteve të ndryshme.
- Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.
- Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit.
- Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare.
- Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe asaj botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike.

Më poshtë është dhënë një përshkrim i shkurtër i këtyre kompetencave.

Gjuhë shqipe

Të lexuarit e teksteve të ndryshme

Lënda e gjuhës shqipe u krijon mundësi nxënësve që të lexojnë në mënyrë aktive dhe kritike, si dhe ta përthithin mirë e shpejt informacionin. Një lexues aktiv dhe kritik është ai, që jo vetëm i kupton dhe i vlerëson njohuritë që komunikohen në një tekst, por edhe i përdor ato në kontekste të reja. Për ta realizuar këtë, nxënësit zbatojnë një sërë strategjish të të kuptuarit, si dhe njihen me një shumëllojshmëri tekstesh.

Njohja me tekste të ndryshme u jep mundësinë nxënësve që të zbulojnë interesat dhe prirjet e tyre dhe, gjithashtu, ta kenë më të lehtë të zgjedhin orientimin e karrierës së tyre.

Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Një nga qëllimet e programit të gjuhës shqipe është që nxënësit të demonstrojnë siguri dhe saktësi kur shkruajnë, të hulumtojnë para se të shkruajnë një tekst, si dhe të komunikojnë me kompetencë, duke përdorur forma dhe stile të ndryshme të shkruarit.

Gjatë tri viteve, nxënësit krijojnë, organizojnë dhe përzgjedhin ide për të shkruar për qëllime, lexues dhe situata të ndryshme. Ata zbatojnë hapat e domosdoshëm të procesit të shkrimit (planifikimi, organizimi i punës me shkrim, rishikimi, redaktimi etj.). Gjatë të shkruarit, nxënësit zbatojnë karakteristikat e teksteve dhe rregullat gramatikore e drejtshkrimore.

Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit demonstrojnë ndërgjegjësim dhe saktësi në përdorimin e njohurive rreth sistemit gjuhësor të shqipes. Ata i konsolidojnë njohuritë gjuhësore, aftësohen ta përdorin gjuhën saktë dhe brenda rregullave gramatikore. Nxënësit i përdorin njohuritë gjuhësore për të organizuar, për të redaktuar dhe për të përmirësuar shkrimet e tyre, për të folur qartë dhe saktë, për të gjykuar gjuhën e një teksti që dëgjojnë ose lexojnë etj. Në këtë cikël, nxënësit përcaktojnë dallimet mes gjuhës së folur e gjuhës së shkruar, analizojnë regjistrat e gjuhës, vlerësojnë pasurinë leksikore të gjuhës shqipe dhe zbatojnë rregullat drejtshkrimore dhe ato të pikësimit.

Letërsi

Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Nxënësit fitojnë teknikat e analizës së veprave letrare, të cilat do t'u shërbejnë në shkollë dhe në jetë. Ata analizojnë dhe interpretojnë vepra të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare. Duke studiuar tiparet kryesore të gjinive dhe të llojeve letrare, nxënësit marrin njohuritë dhe fitojnë

aftësitë e nevojshme për ta kuptuar më mirë natyrën e letërsisë. Këto tipare, nxënësi nuk i mëson thjesht në mënyrë teorike, por të konkretizuara në veprat ose fragmentet letrare. Gjatë tri viteve, nxënësit do të lexojnë dhe do të punojnë me tekste poetike, dramatike dhe tekste në prozë.

Gjatë analizës dhe interpretimit të veprave letrare, nxënësit dallojnë edhe mjetet e shumta e gjuhës, të cilat janë përdorur për të krijuar tekste jo vetëm me kuptim, por edhe estetikisht të bukura.

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe asaj botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike.

Nxënësit krijojnë një pasqyrë të qartë:

- të fazave të ndryshme të zhvillimit të letërsisë shqipe dhe të letërsisë botërore;
- të lidhjeve mes periudhave të ndryshme historike dhe drejtimeve letrare;
- të gjinive letrare, të autorëve dhe veprave më përfaqësuese të një periudhe historike ose të një drejtimi letrar.

Mësimi i letërsisë përqendrohet në karakteristikat kryesore të një periudhe, duke u dhënë mundësi nxënësve të krijojnë një ide të përgjithshme rreth origjinës, përhapjes dhe tipareve të një drejtimi letrar, si dhe të gjinive e të llojeve që lëvrohen.

Letërsia shqipe studiohet paralelisht me letërsinë botërore duke u kushtuar vëmendje të përbashkëtave dhe dallimeve mes tyre. Në këtë mënyrë, nxënësit kuptojnë që letërsia shqipe nuk është një njësi e veçuar dhe e ndarë, por pjesë e pasurisë letrare botërore.

4. Pësja e gjuhës shqipe dhe e letërsisë në test

Tabela e mëposhtme paraqet pëshën në pikë të gjuhës shqipe dhe të letërsisë në test. Pikët për shkrimin e esesë janë të përbashkëta për të dyja lëndët

Lëndët	Pësja
Gjuhë shqipe	afërsisht 40 %
Të lexuarit e teksteve të ndryshme (afërsisht 22%)	
Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit (afërsisht 18%)	
Letërsi	afërsisht 40 %
Të shkruarit (ese)	afërsisht 20 %

5. Struktura e testit

Testi i gjuhës dhe i letërsisë do të ketë tri pjesë.

Pjesa e parë: Tekst joletrar dhe njohuritë e aftësitë gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit.	Teksti joletrar (përshkrues, rrëfyes, informues paraqitës dhe argumentues) do të jetë i panjohur për nxënësit. Njohuritë dhe aftësitë gramatikore, drejtshkrimore e të pikësimit do të integrohen me tekstin joletrar.
Pjesa e dytë: Tekst letrar	Fragmentet do të jenë nga veprat letrare të përcaktuara në programin orientues.
Pjesa e tretë: Ese	Eseja dëshmon formimin gjuhësor dhe letrar të nxënësit. Tema e esesë mund të lidhet me njërin nga pjesët e mësipërme.

6. Llojet e pyetjeve/ kërkesave të rekomanduara

Pyetjet që përdoren në test janë:

- Pyetje me alternativa.
- Pyetje me përgjigje: *E vërtetë/ E rreme; Po/Jo; E saktë/ E gabuar.*
- Pyetje me kombinime (me çiftim).
- Pyetje me përgjigje të shkurtër ose me plotësim.
- Pyetje subjektive me përgjigje të kufizuar.
- Pyetje subjektive me përgjigje të zgjeruar.
- Etj.

Pyetjet ose kërkesat në tekst do të jenë të tri niveleve. Tabela e mëposhtme paraqet përqindjen e pikëve në test për secilin nivel.

Niveli bazë	Niveli mesatar	Niveli i lartë
40%	40%	20%

7. Njohuritë dhe aftësitë sipas kompetencave

Për secilën kompetencë janë paraqitur shkathtësitë dhe njohuritë që duhet të demonstrojnë nxënësi.

Kompetenca: Të lexuarit e teksteve të ndryshme	
Njohuritë	Aftësitë
Tekste përshkruese - Teknikat e shkrimit të tekstit përshkrues, si p.sh., përshkrim i një personi real, një personazhi apo personaliteti, një mjedisi, një vendi, një objekti etj. - Karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike të tekstit përshkrues. Tekste rrëfyese - Teknikat e shkrimit të tekstit rrëfyës, si p.sh., rrëfim i një ngjarjeje reale ose një artikull në një gazetë për një ngjarje, kronikë, ditar, autobiografi, biografi etj. - Karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike të tekstit rrëfyës. Tekste argumentuese - Teknikat e shkrimit të tekstit argumentues (një reklamë, një fjalim, një ese etj.). - Karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike të teksteve argumentuese. Tekste informuese-paraqitëse - Teknikat e shkrimit të tekstit informues-paraqitës, si p.sh., minutat e një takimi, një jetëshkrim, një aplikim për punë, një ese etj. - Karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike të teksteve informuese-paraqitëse.	Të kuptuarit e tekstit dhe reflektimi ndaj tij Nxënësi: - përdor njohuritë paraprake (p.sh., njohuri rreth temës, koncepte të njohura ose njohuri socio-kulturore) për të kuptuar tekstin; - shfrytëzon elemente, si: titulli, nëntitujt, organizimi i tekstit, fjalori etj., për të kuptuar tekstin; - bën parashikime duke u bazuar tek titulli, nëntitujt, fjalët kyç etj.; - parafrazon informacionin ose idetë e tekstit; - përmbledh idetë (në një ose disa paragrafë); - identifikon qëllimin dhe audiencën (lexuesin) e tekstit; - veçon idenë/idetë kryesore; - dallon shkakun nga pasoja, faktin nga opinionin, problemin dhe zgjidhjen; - kategorizon dhe klasifikon detajet e dhëna në tekst; - analizon modelet organizative të teksteve: renditje e ideve ose ngjarjeve, krahasim-kontrast, shkak-pasojë etj.; - nxjerr përfundime nga informacioni i tekstit, nga pikëpamjet e autorit etj.; - interpreton dhe integron informacionin e marrë nga një sërë burimesh (harta, grafikë, diagrame etj.); - identifikon dhe analizon elementet pamore (fotografi, ilustrime), të përdorura në tekstet e shkruara për të arritur qëllime të ndryshme; - bën përgjithësime në nivel kritik duke përdorur lidhjet brenda dhe jashtë teksteve; - vlerëson informacionin (besueshmërinë, saktësinë, mjaftueshmërinë, përdorimin e

	propagandës, ekzagjerimin, gabimin etj.); - bën lidhje mes një teksti dhe pikëpamjeve ose ideve të tjera jashtë tekstit, si dhe idetë e tekstit i zbaton në një situatë të re; - krahason lloje të ndryshme tekstesh (p.sh., një tekst rrëfyes letrar me një tekst rrëfyes joletrar), duke u bazuar në kritere të përgjithshme ose në të dhëna specifike; - dallon dhe krahason elemente të stilit në një shumëllojshmëri tekstesh; - identifikon karakteristika të formës të teksteve, si: hyrja, mbyllja, paragrafi, fragmenti, evidenca, indeksi, fjalorthi, tabela e përmbajtjes (kapitulli, prologu, epilogu) etj.; - identifikon karakteristika përmbajtësore të teksteve, si: tema, tematika, motivi etj.; - analizon veçoritë gjuhësore të një teksti; - analizon dhe vlerëson përdorimin e referencave të besueshme brenda një teksti; - tregon se zgjedhja e fjalëve kyç ndikon në shtjellimin e temës ose në arritjen e qëllimit të saj; - dallon vërtetësinë dhe koherencën e argumenteve në tekste të ndryshme; - analizon qëndrimin e autorit ndaj “lëndës” që trajton dhe ndaj lexuesit të cilit i drejtohet; - përdor informacione nga burime të ndryshme për një çështje të caktuar, për të ndërtuar një argument dhe për të nxjerrë përfundime; - vlerëson cilësinë e informacionit të përzgjedhur nga autori. - demonstroi se si stili i autorit mund të ndikojë te lexuesi nëpërmjet zgjedhjes së fjalëve, teknikave të shkrimit, përdorimit të gjuhës së figurshme etj. Llojet e teksteve Nxënësi: - përcakton funksionet, llojin, qëllimet teknikat dhe karakteristikat gjuhësore, stilistike dhe strukturore të teksteve joletrare, si: • teksti përshkrues, • teksti rrëfyes, • teksti argumentues,
--	--

	• teksti informues-paraqitës. Pasurimi i fjalorit Nxënësi: - përdor gjerësisht dhe me efikasitet dukuritë semantike, si: polisemia, homonimia, sinonimia, antonimia; - shfrytëzon përdorime të gjuhës së figurshme nga tekste të ndryshme; - dallon kuptimin e drejtpërdrejtë nga i nënkuptuari për të interpretuar forcën e fjalës.
--	--

Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	
Njohuritë	Aftësitë
- Ese përshkruese. - Ese rrëfyese. - Ese argumentuese. - Ese informuese- paraqitëse (shpjeguese).	Shkrimi si proces Nxënësi: - planifikon duke identifikuar qëllimin, lexuesin dhe kontekstin; - krijon ose mbledh ide të përshtatshme për punët me shkrim duke përdorur strategji të ndryshme, si: shkrimi i lirë, stuhi mendimi, hartë koncepti, kllaster etj.; - rishikon esenë për të përmirësuar strukturën, qartësinë dhe për të arritur saktësi në shprehjen e kuptimit; - identifikon elementet e gjuhës dhe të përmbajtjes (fakte, ide, detaje etj.), të cilat janë të papërshtatshme për lexuesin dhe kontekstin, dhe i zëvendëson, shton, fshin ose riorganizon fjalë, fraza, fjali, fakte, ide, detaje përshkruese, emocionale etj.; - përmirëson renditjen e fakteve, ideve dhe detajeve brenda ose në mes të paragrafëve; - korrigjon gabimet gjuhësore (gramatikë, drejtshkrim, pikësim). Shkrimi si produkt Nxënësi: - organizon fakte dhe ide në përshtatje me qëllimin, lexuesin dhe llojin e tekstit; - mbështet mesazhin kryesor të një teksti me detaje, fakte dhe shembuj të përshtatshëm për qëllimin, lexuesin, kontekstin etj.; - i përmbahet temës së esesë;

	- shkruan ese koherente; - përdor një fjali të temës për të futur idenë kryesore në një paragraf; - përpunon dhe shtjellon idenë kryesore të një paragrafi duke përdorur shembuj, detaje, fakte, përshkrime etj.; - rimerr idenë kryesore në paragrafin përmbyllës të tekstit dhe shkruan mbylljen e tij; - përdor strategji mbështetëse (anekdota personale, mbështetje të besimet e përbashkëta, opinione ekspertësh) në mënyrë që të bindë lexuesin; - ka stil dhe origjinalitet në ese. Llojet e teksteve Nxënësi: - shkruan ese përshkruese me tema të ndryshme; - shkruan ese rrëfyese me tema të ndryshme; - shkruan ese argumentuese me tema të ndryshme; - shkruan ese informuese/paraqitëse (shpjeguese) me tema të ndryshme.
--	---

Kompetenca: Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit	
Njohuritë	Aftësitë
Morfologji Klasat e fjalëve, të ndryshueshme dhe të pandryshueshme. Emri - Emrat që e ndërrojnë gjininë në numrin shumës. - Emrat që e formojnë shumësin me prapashtesa, si: <i>-ë, -nj, -ër, -inj, -ra</i> ose me ndërrime tingujsh. Folja - Foljet kalimtare dhe jokalimtare. - Mënyra dëftore dhe habitore, forma veprore dhe joveprore e foljeve të parregullta.	Morfologji Nxënësi: - përcakton klasat e fjalëve dhe argumenton përgjigjen e tij; - klasifikon fjalët në të ndryshueshme dhe në të pandryshueshme; - dallon emrat e gjinisë mashkullore që e ndryshojnë gjininë, kur kalojnë në numrin shumës; - përcakton prapashtesën me të cilën e formojnë numrin shumës, disa emra mashkullorë, si: • prapashtesën <i>-e</i> (<i>shtigje, male, vende, mendime, personazhe, insekte</i> etj.); • prapashtesën <i>-ra</i> (<i>djathëra, vajra, mallra, ujëra, shira</i> etj.); - përdor drejt emrat që në numrin shumës marrin prapashtesat <i>ë, -nj, -ër, -inj, -ra</i> ose ndërrojnë tingujt si p.sh.: <i>dibranë, drejtorë, arsimtarë, florinj, priftërinj, prindër, erëra, brigje, kapituj</i> etj.;

Mbiemri - Shumësi i mbiemrave. Përdorimi në shumës i mbiemrave që përcaktojnë emra mashkullorë me shumësin me - <i>e</i>, - <i>ra</i> dhe me - <i>a</i>. Përemri - Llojet e përemrave, sipas kuptimit që kanë dhe funksionit që kryejnë (vetorë, vetvetorë, dëftorë, pronorë, pyetës, lidhorë, të pacaktuar). Kategoritë e tyre gramatikore. Ndajfolja - Llojet e ndajfoljeve. Dallimi i ndajfoljeve nga parafrjalët me të njëjtën formë. - Shkallët e ndajfoljeve. - Lokucionet ndajfoljore. Lidhëza - Lidhëzat bashkërenditëse dhe lidhëzat nënrenditëse.	- dallon dhe krahason foljet kalimtare dhe jokalistare; - ndërton fjali me folje kalimtare dhe jokalistare; - zgjedhon foljet e parregullta (<i>jam, them, rri, dua etj.</i>) në kohët e mënyrës dëftore dhe habitore, në formën veprorë dhe joveprorë; - dallon variantin e saktë të foljet që në gjuhën e folur kanë disa trajta si p.sh.: <i>shkoj/shkoi/shkonj, shkoja/shkonja, por</i> edhe trajtën kryesore normative <i>mat/mas, matja/masja, flitni/flisni; bërtisni/bërtitni etj.</i>; - vendos në trajtën e duhur mbiemrat ose fjalët e tjera përcaktuese pas emrave që e ndërrojnë gjininë në numrin shumës si p.sh.: <i>mendime të zymta, personazhe interesante, vende malore, ujëra të rrëmbyeshme, djathëra të kripura etj.</i>; - dallon dhe përdor në fjali, lloje të ndryshme përemrash; - përcakton kategoritë gramatikore të përemrave; - lakon përemrat vetorë; - dallon ndajfoljet dhe përcakton llojin e tyre; - përcakton shkallën e ndajfoljes; - tregon se çfarë janë lokucionet ndajfoljore dhe ndërton fjali me to; - përcakton se si janë formuar lokucionet ndajfoljore; - dallon ndajfoljen nga parafrjalët me të njëjtën formë; - përcakton llojin e lidhëzave bashkërenditëse dhe lidhëzave nënrenditëse; - përdor drejt në fjali lidhëzat;
Sintaksë - Gjymtyrët e dyta. - Kundrinori, llojet (kundrinori i drejtë, kundrinori i zhdrejtë me ose pa parafrjalë). - Rrethanori, llojet (rrethanori i vendit, i kohës, i shkakut, i qëllimit, i mënyrës etj.). - Përcaktori, llojet (përcaktori me përshtatje, përcaktori me drejtim, përcaktori me bashkim, ndajshkrim). - Gjymtyrët homogjene. - Gjymtyrët e veçuara. - Fjalë e thjeshtë dhe fjalë e përbërë. - Fjalë e përbërë me bashkërenditje dhe fjalë e	Sintaksë Nxënësi: - përcakton gjymtyrët e dyta në një fjali dhe argumenton përgjigjen e tij; - dallon kundrinorin dhe përcakton llojin e tij; - tregon se me çfarë është shprehur kundrinori; - ndërton fjali me kundrinorë të llojeve të ndryshme; - dallon rrethanorin dhe përcakton llojin e tij; - përcakton se me çfarë është shprehur rrethanori; - ndërton fjali me rrethanorë të llojeve të ndryshme; - dallon përcaktorin dhe përcakton llojin e tij;

përbërë me nënrenditje.	- tregon se me çfarë është shprehur përcaktori; - formon fjali me përcaktorë të llojeve të ndryshme; - krahason përcaktorin me gjymtyrët e tjera të fjalisë; - dallon gjymtyrët homogjene në fjali; - dallon dhe përdor në fjali gjymtyrët e veçuara; - përcakton tiparet e fjalisë së thjeshtë dhe ato të fjalisë së përbërë; - analizon tiparet e përbashkëta dhe tiparet të veçanta mes fjalisë së thjeshtë dhe fjalisë së përbërë; - dallon marrëdhëniet kuptimore dhe lidhjet sintaksore që realizohen në fjalinë e thjeshtë dhe në fjalinë e përbërë; - dallon llojin e fjalive me bashkërenditje; - ndërton fjali të përbëra me bashkërenditje këpujore, kundërshtore, veçuese, përmbyllëse dhe shkakore-motivuese; - dallon llojet e fjalive të përbëra me nënrenditje; - ndërton fjali të përbëra me nënrenditje; - analizon fjalitë e përbëra me shumë pjesë; - ndërton skemat e fjalive të përbëra me shumë pjesë; - ndërton një fjali të përbërë në bazë të një skeme të dhënë; - përshtat në kohë dhe në mënyrë foljet (kallëzuesit) në pjesët e fjalisë së përbërë; - përdor drejt shenjat e pikësimit të fjalitë e përbëra.
Leksikologji - Ligjërimet në gjuhën shqipe (ligjërimi i thjeshtë, ligjërimi bisedor dhe ligjërimi libror). - Stilet funksionale në gjuhën shqipe: stili i letërsisë artistike, stili politiko-shoqëror, stili shkencor-teknik, stili juridik- administrativ.	Leksikologji Nxënësi: - përcakton llojet e ligjërimeve në gjuhën shqipe; - analizon tiparet e ligjërimit të thjeshtë, të ligjërimit bisedor dhe të ligjërimit libror; - krahason ligjërimin bisedor me ligjërimin e thjeshtë; - dallon llojin e ligjërimit në një tekst; - ndërton tekste të shkurtra të cilat kanë tiparet e ligjërimit të thjeshtë, të ligjërimit libror ose të ligjërimit libror; - përcakton kuptimin e termit “stil funksional”; - përcakton se cilit stil i përket një tekst; - analizon elementet kryesore të secilit stil; - krahason stilet me njëri-tjetrin; - harton tekste të shkurtra që u përkasin stileve të ndryshme (stili i letërsisë artistike, stili politiko-shoqëror, stili shkencor-teknik, stili juridik-administrativ).

Drejtshkrim dhe pikësim - Përdorimi i shenjave të pikësimit (presja, pikëpresja, dy pikat, tri pikat, kllapat, thonjëzat). - Përdorimi i presjes të fjalitë e përbëra dhe të fjalitë e ndërmjetme, si dhe i shenjave të tjera të pikësimit të fjalitë e ndërkallura.	Drejtshkrim dhe pikësim Nxënësi: - shkruan dhe përdor drejt shenjat e pikësimit (presja, pikëpresja, dy pikat); - përdor drejt shenjat e pikësimit (tri pikat, kllapat dhe thonjëzat); - përdor drejt presjen të fjalitë e ndërmjetme dhe shenjat e pikësimit në fjalitë e ndërkallura.
--	---

Kompetenca: Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	
Njohuritë	Aftësitë¹
Letërsia dhe gjinitë letrare - Karakteri historik i gjinive letrare. - Veçoritë e llojeve të gjinisë epike, si: poema epike, miti, legjenda, përralla, tregimi, novela, romani. - Veçoritë e llojeve të gjinisë lirike, si: elegjia, himni, soneti, lirika modern, poema epike etj. - Veçoritë e llojeve të gjinisë dramatike, si: tragjedia, komedia, drama. Figurat stilistike - Figurat e kuptimit: krahasimi, personifikimi, antiteza, kontrasti, hiperbola, simboli, paralelizmi figurativ. - Figurat e shqiptimit poetik: pyetja retorike, pasthirrma, apostrofa, epanastrofa, aliteracioni. - Figurat e fjalëve dhe të shprehjeve: metafora, alegoria. - Figurat e sintaksës poetike: anasjella (inversioni), enumeracioni, shkallëzimi. Elementet e tekstit letrar - Fabula dhe subjekti. - Tema dhe motivet. - Rrëfimtari, autori dhe lexuesi. - Format e rrëfimit.	Elementet e tekstit letrar a) Fabula dhe subjekti Nxënësi: - rrëfen dhe analizon subjektin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj nga teksti ose fragmenti; - përcakton dhe analizon fabulën e një teksti; - bën dallimin mes fabulës dhe subjektit; - analizon ngjarjet kryesore të një teksti; - dallon ngjarjet që shënojnë hyrjen, pikën e lidhjes, zhvillimin, pikën kulmore, zgjidhjen, si dhe shpjegon funksionin dhe rëndësinë e tyre; - dallon konfliktin/konfliktet dhe shpjegon mënyrën se si zgjidhen ato në vepër; - analizon marrëdhëniet mes skenave të veçanta (skena, episode, pamje) dhe tekstit si i tërë; - përshkruan strukturën narrative në një tekst dhe jep argumentet e tij rreth përzgjedhjes së saj nga autori. b) Personazhet Nxënësi: - analizon dhe vlerëson personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe në mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.; - analizon se si ndryshon ose zhvillohet një personazh; - evidenton ngjashmëritë dhe dallimet mes personazheve (karakter, sjelljet etj.); - analizon marrëdhëniet mes personazheve, si p.sh., ndikimi që ka një personazh te një personazh tjetër; - dallon llojet e personazheve (realë, historikë, të trilluar, mitologjikë, të jashtëzakonshëm, kryesorë, dytësorë); - shpreh dhe argumenton pëlqimet e tij për një personazh; - interpreton simbolikën e një personazhi (nëse ka të tillë); - analizon marrëdhëniet njerëzore dhe sjelljet e njeriut përmes studimit të personazheve. c) Mjedis, koha dhe atmosfera Nxënësi:

¹ Veprat për të cilat nxënësit do të demonstrojnë këto njohuri dhe aftësi janë dhënë më poshtë.

- Sistemi i personazheve. Marrëdhëniet kryesore mes personazheve. - Mjedisi, koha dhe atmosfera. - Stili. Gjuha e një veprë letrare. - Ritmi dhe vargu (edhe vargu i lirë). Rima dhe llojet e saj. - Strofa, funksioni dhe llojet e saj.	- përshkruan dhe analizon mjedisin dhe kohën në një vepër letrare; - veçon mjetet artistike që përdor autori për të dhënë mjedisin dhe kohën; - përshkruan ndikimin e tij emocional dhe psikologjik nga leximi i një veprë letrare; - analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha apo rrethanat e një teksti. d) Tematika Nxënësi: - dallon temën dhe motivet e një teksti; - analizon dhe shpjegon mënyrën që zgjedh autori për të shtjelluar një temë ose një motiv të caktuar; - demonstroi vetëdije në lidhje me faktin që zhvillimi i një teme (ose motivi) nga një shkrimtar zbulon një pamje ose një aspekt të veçantë të jetës. e) Stili dhe gjuha Nxënësi: - veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst; - analizon dhe vlerëson gjuhën e figurshme; - vlerëson cilësitë estetike të gjuhës së një teksti. Konteksti historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror Nxënësi: - gjykon rreth kontekstit historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror në të cilin është shkruar një tekst; - shpjegon se si konteksti ndikon në vepër. Lidhja mes tekstit dhe lexuesit Nxënësi: - tregon se si përvojat personale, vlerat, besimet e tij mund të ndikojnë në mënyrën se si ai e kupton dhe e interpreton një tekst; - tregon se si një tekst e informon lexuesin rreth natyrës njerëzore. Reflektimi ndaj tekstit Nxënësi: - formulon mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij rreth tekstit, duke e lidhur atë me njohuritë e mëparshme; - reflekton në mënyrë kritike përmes analizave, interpretimit, vlerësimit, krahasimit dhe sintezës së tekstit; - shprehet në mënyra të ndryshme për tekstet që lexon, si p.sh.: dramatizime, ese, punë krijuese me shkrim, muzikë, pikturë etj. Ndërtimi dhe komunikimi i argumenteve Nxënësi: - mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti; - organizon qartë, saktë dhe në mënyrë logjike mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij (me gojë dhe me shkrim).
--	--

Veprat letrare të mëposhtme duhen punuar me nxënësit. Hartuesit e testit do ta ndërtojnë pjesën e testit të letërsisë duke iu referuar kësaj liste.

Kompetenca: Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe asaj botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike	
Njohuritë	Aftësitë
Homeri - Iliada. - Rëndësia e Homerit në letërsinë e mëvonshme.	Homeri “Iliada” Nxënësi: - vlerëson rëndësinë e Homerit në letërsinë e mëvonshme; - interpreton, analizon dhe gjykon për vlerat artistike të poemës “Iliada”
Aligeri - Ferri. - Rëndësia e kësaj vepre.	Dante Aligeri “Ferri” Nxënësi: - interpreton, analizon dhe gjykon për vlerat artistike të Ferrit; - analizon vlerat, strukturën, filozofinë dhe rëndësinë e “Ferrit”.
Shekspir - Hamleti. - Rëndësia e Shekspirit në letërsinë botërore.	Shekspir “Hamleti” Nxënësi: - interpreton, analizon dhe gjykon për vlerat artistike të veprës “Hamleti”; - diskuton dhe vlerëson rëndësinë e krijimtarisë së Shekspirit në letërsinë botërore.
Hygo - Katedralja e Parisit. - Hygoi si prijës i romantizmit.	Hygo “Katedralja e Parisit” Nxënësi: - vlerëson rolin e Hygoit në letërsinë romantike dhe në letërsinë e mëvonshme franceze; - interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson romanin “Katedralja e Parisit”.
N. Frashëri - Lulet e verës. - Naim Frashëri, figura më përfaqësuese e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Kontributi i tij në çështjen kombëtare, si dhe në gjuhën e në letërsinë shqipe. -	N. Frashëri “Lulet e verës” Nxënësi: - vlerëson kontributin e Naim Frashërit në çështjen kombëtare dhe në lëvrimin e gjuhës shqipe; - identifikon veprat letrare të Naim Frashërit; - dallon tiparet e romantizmit që gjejnë shprehje në veprën e Naim Frashërit; - interpreton, analizon dhe gjykon për vlerat artistike të vëllimit poetik “Lulet e verës”.
Albert Kamy - I huaji. - Ekzistencializmi në artin e Kamysë. - Absurdi i qenies njerëzore, vetmia etj.	Albert Kamy: “I huaji” Nxënësi: - formulon idenë e Kamysë për absurdin; - analizon raportin: absurd, shpërfillje, shpresë, revoltë, në veprën e Kamysë; - interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson romanin “I huaji”.

Lasgush Poradeci - Ylli i zemrës, - Poeti modern i shqipes. - Vendlindja dhe dashuria në jetën e Poradecit. - Mbështetja në trashëgiminë poetike të Naimit dhe në letërsinë moderne të Europës.	Lasgush Poradeci: “Ylli i zemrës” Nxënësi: - analizon risitë dhe origjinalitetin që solli Poradeci në poezinë shqipe; - analizon motivet kryesore të poezisë së Poradecit; - veçon dhe gjykon ndikimet që pati Poradeci nga krijimtaria e Naim Frashërit dhe nga poezia moderne e Evropës; - interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson vëllimin poetik “Ylli i zemrës”.
Migjeni - Novelat e qytetit të veriut. - Vargjet e lira. - Fryma e re që solli Migjeni në letërsinë shqipe (në formë dhe në përmbajtje), si p.sh.: shkëputja nga tradita, temat e ndaluara, vargu i lirë, shembja e kulteve politike, fetare etj. - Njeriu në letërsinë e Migjenit (jeta në situata ekzistenciale).	Migjeni: “Novelat e qytetit të veriut” dhe “Vargjet e lira” Nxënësi: - vlerëson frymën e re që sjell Migjeni në letërsinë shqipe (në formë dhe në përmbajtje), si p.sh.: shkëputjen nga letërsia pararendëse, trajtimin e temave tabu, vargu i lirë etj.; - portretizon njeriun në krijimtarinë e Migjenit, duke e krahasuar edhe me krijimtarinë e letërsisë së mëparshme, por edhe me letërsinë e kohës së tij; - interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson vëllimin në prozë “Novelat e qytetit të veriut”; - interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson vëllimin poetik “Vargjet e lira”.
Ismail Kadare - Pallati i ëndrrave. - Vendi që zë Kadare në letërsinë shqipe. - Bota shqiptare në veprën e Kadaresë.	Ismail Kadare “Pallati i ëndrrave” Nxënësi: - veçon dhe analizon risitë që sjell Kadare në letërsinë shqipe; - interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson romanin “Pallati i ëndrrave”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN KOMBËTAR PËR MATURËN
SHTETËRORE
PËR SHKOLLAT ARTISTIKE DHE SPORTIVE**

LËNDA : MATEMATIKË

VITI SHKOLLOR 2018-2019

Tiranë tetor 2018

I. HYRJE

Matematika e përgatit nxënësin për rolet e tijtë ardhshme në shoqëri. Nëpërmjet njohurive thelbësore matematikore dhe aftësive të arsytimit, të logjikës, të komunikimit dhe të modelimit, ajo mundëson zhvillimin e personalitetit të nxënësit, mundëson zhvillimin e aftësive për të menduar në mënyrë kritike dhe për të hulumtuar, duke nxitur kështu kërshërinë dhe inkurajimin për zbulim, siguron vetëbesimin për zgjidhjen e situatave problemore në jetën e përditshme. Matematika është një nga shtatë fushat e kurrikulës së arsimit të mesëm të lartë dhe përmban vetëm lëndën e matematikës, e cila tradicionalisht vazhdon të jetë pjesë themelore e arsimit parauniversitar. Në arsimin e mesëm të lartë programi i lëndës së matematikës bërthamë është konceptuar mbi bazën e kuptimeve dhe shprehive **themelore** për përgatitjen e nxënësve. Ata kanë integruar njohuri nga numri, algjebra, gjeometria duke siguruar zgjerim të mëtejshëm të njohurive, nga trigonometria, funksioni, derivati dhe integrali, si dhe nga statistika e probabiliteti. Matematika, përveç si lëndë shkollore, nëpërmjet forcës së abstragimit, argumentit logjik dhe bukurisë së vërtetimit, paraqitet si një disiplinë intelektuale dhe si një burim kënaqësie estetike.

Programi orientues për provimin e Maturës Shtetërore në lëndën e matematikës, nëpërmjet përqendrimit në konceptet dhe shprehitë kryesore të mësuara gjatë viteve, ka si qëllim të orientojë punën e mësuesit, përgatitjen e nxënësve dhe hartuesit e testeve përfundimtare për Provimin e Maturës Shtetërore.

Hartimi i programit orientues është mbështetur në kurrikulën me kompetenca të lëndës së matematikës së arsimit të mesëm të lartë, duke mbajtur parasysh formimin e njohurive dhe rezultateve të nxënësve nëpërmjet modelimeve, arsytimeve, zgjidhjes problemore dhe interpretimeve në situata të thjeshta dhe më komplekse.

II. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues i lëndës së matematikës për provimin e detyruar të Maturës Shtetërore të klasës XII arsimit të orientuar artistike dhe sportive bazohet në parimin se të zotërosh njohuri matematike do të thotë të jesh në gjendje t'i zbatosh ato:

- në tematika të ndryshme të vetë lëndës së matematikës;
- në fusha të tjera kurrikulare;
- në situata të jetës së përditshme.

Programi orientues për përgatitjen e provimit të lëndës së matematikës bërthamë (niveli bazë) është mbështetur në:

- programet e lëndës së matematikës bërthamë (niveli bazë) për klasat 10-12;
- udhëzuesin për zhvillimin e kurrikulës arsimit të mesëm të lartë;
- nivelet e arritjes së lëndës së matematikës për klasat 10-12;

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi përmban *strukturën e testit* në të cilën jepen kompetenca matematikore, tematikat si dhe pesha e tyre. Rubrika “*Llojet e pyetjeve/kërkesave/ushtrimeve*” përmban llojet e pyetjeve që vlerësojnë në mënyrë efektive kompetencat që zotëron nxënësi. Programi përmban rubrikën *e rezultateve të të nxënies* ku përcaktohen konceptet dhe aftësitë kryesore për çdo tematikë të lëndës së matematikës për klasat 10-12.

III. STRUKTURA E TESTIT

Një nga aspektet më të rëndësishme në kurrikulën e matematikës është zhvillimi i kompetencave matematikore, të cilat e ndihmojnë nxënësin të kuptojë përdorimin e matematikës në mënyrë efektive. Njohuritë matematikore bëhen kuptimplota dhe të fuqishme, nëse marrin jetë në kurrikul dhe zbatohen në situata praktike. Situata të zgjidhjes së problemeve mund të nxirren nga fusha të lidhura ngushtë, si: shkenca kompjuterike, biznes, financë, turizëm, biologji, fizikë, teknologji, por edhe nga fusha të tjera, si: histori, gjeografi, shkenca sociale ose arte. Realizimi i kompetencave përgjatë gjithë zhvillimit të lëndës së matematikës ndihmon nxënësin:

- të zhvillojë konceptet matematikore, shkathtësitë dhe modelimin matematikor;
- të përzgjedhë dhe të zbatojë teknikat matematikore për zgjidhjen e problemeve;
- të arsyetojë veprimet e tij matematikore;
- të nxjerrë përfundime duke dhënë gjykimin e tij;
- të kuptojë, interpretojë dhe komunikojë informacionin matematikor në forma të ndryshme të përshtatshme në një kontekst të dhënë.

Nëpërmjet testit të lëndës së matematikës në Provimin e Maturës Shtetërore, nxënësi do të vlerësohet për realizimin e kompetencave matematikore sipas peshave të mëposhtme:

Kompetencat matematikore	Përshkrimi i kompetencave	Pesha
Lidhja konceptuale dhe të menduarit matematik	Nxënësi kupton ndërtimin e koncepteve matematike për të formuar një të tërë dhe përdor varësitë ndërmjet këtyre koncepteve. Të menduarit matematik zhvillon lidhjen ndërmjet koncepteve duke i ndërtuar dhe zbatuar ato në proceset matematikore përkatëse. Treguesit kryesorë janë: ✓ rikujton faktet me saktësi; ✓ përdor terminologjinë dhe përkufizimet matematikore; ✓ përdor dhe interpreton saktë konceptet dhe simbolet matematikore; ✓ kryen me saktësi procedurat standard;	40%
Zgjidhja e situatës problemore	Nxënësi përshkruan dhe zgjidh situata problemore, të nivelit praktik të marra nga përvojat e përbashkëta të jetës së përditshme dhe të nivelit abstrakt duke zhvilluar kapacitetin e tij intelektual dhe intuitën krijuese. Nxënësi interpreton rezultate të zgjidhjes në kontekstin e problemit të dhënë. Treguesit kryesorë janë: ✓ përcaktimi i të dhënave të situatës problemore; ✓ interpretimi i një situatë problemore; ✓ zbatimi i hapave të ndryshme për zgjidhjen e situatës problemore; ✓ vlefshmëria e zgjidhjes së situatës problemore; ✓ paraqitja e zgjidhjes së situatës problemore.	20%
Arsyetimi dhe vërtetimi matematik	Nxënësi përdor arsyetimin dhe argumentimin si aspekte themelore të matematikës. Arsyetimi ka të bëjë me organizimin logjik të fakteve, ideve ose koncepteve në mënyrë që të arrijë në një rezultat më të besueshëm se intuita. Nxënësi organizon konkluzione nga një	20%

	informacion matematikor i dhënë, ndërton zinxhirin e arsyetimit për të arritur në një rezultat, interpreton informacionin me saktësi, vlerëson vlefshmërinë e një argumenti matematikor ose paraqitjen e një informacioni. Treguesit kryesorë janë: ✓ identifikimi i elementeve të situatës matematikore; ✓ përdorimi i koncepteve matematikore dhe proceset e përshtatshme për situatën e dhënë; ✓ arsyetimi për zbatimin e koncepteve dhe proceseve në situatën e dhënë.	
Modelimi matematik	Nxënësi përshkruan dhe krijon modele duke përdorur veprimet themelore matematikore në situata të jetës së përditshme. Modelimi është procesi i paraqitjes së situatës nga jeta reale me gjuhën matematikore. Nëpërmjet përdorimit të teknikave përkatëse, gjendet zgjidhja matematikore, e cila më pas interpretohet në jetën reale. Treguesit kryesorë janë: ✓ interpretimi i situatës në jetën reale; ✓ modelimi në gjuhën matematike; ✓ gjetja e zgjidhjes matematike; ✓ përkthimi i zgjidhjes matematike në zgjidhje të situatës në jetën reale.	20%

Bazuar në këtë kurrikul përmbushja e kompetencave matematikore që një nxënës duhet të zotërojë përgjatë gjithë zhvillimit të lëndës dhe jo vetëm, arrihet nëpërmjet 5 tematikave kryesore: **numri; matja; gjeometria; algjebra dhe funksioni (përfshirë derivatin dhe integralin); statistika dhe probabiliteti.**

Këto tematika, janë bazë për të ndërtuar njohuri, shkathtësi dhe qëndrime e vlera. Për secilën tematikë është **paraqitur pesha që zë secila prej tyre kundrejt orëve totale** të lëndës së matematikës në zhvillimin e njohurive dhe rezultateve të të nxënës që duhet të demonstrojnë nxënësi në përmbushjen e kompetencave matematikore. Tematikat dhe renditja e tyre nuk nënkuptojnë që përmbajtja e testit duhet të zhvillohet në këtë renditje. Në përgatitjen për

përmbushjen e këtij programi orientues do të përdoren programet e lëndës së matematikës, klasat 10-12.

Tematika	Numri	Matjet	Gjeometria	Algjebra dhe funksioni (Derivati dhe Integrali)	Statistika dhe probabiliteti
Pesha	17%	15%	13%	38%	17%

IV. LLOJET E PYETJEVE/ KËRKESAVE/ USHTRIMEVE TË REKOMANDUARA

Kompetenca: Lidhja konceptuale dhe të menduarit matematik	
Përshkrimi: Vlerësimi i kësaj kompetence do të realizohet mbi bazën e lidhjes së koncepteve matematikore, për të formuar një të tërë dhe varësisë ndërmjet koncepteve. Pyetjet do të ndërtohen mbi bazën e zbatimit të proceseve matematikore duke rikujtuar fakte, duke përdorur terminologji/përkufizime matematikore, duke përdorur dhe interpretuar koncepte apo simbole matematikore.	Llojet e pyetjeve/kërkesave/ushtrimeve: • Ushtrime që tregojnë lidhje të koncepteve apo përdorimit të simboleve. • Ushtrime me përzgjedhje konceptesh apo simbolesh. • Plotësimi i vendeve bosh me informacionin e duhur nga një proces matematikor. • Ushtrime me përgjigje <i>po/jo</i>. • Ushtrime me disa alternativa (përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 alternativat). • Ushtrime ku kërkohet marrja dhe përzgjedhja e informacionit të duhur nga një situatë e dhënë. • Ushtrime të tipit e saktë /e gabuar. • Ushtrime me bashkimin e elementeve të dy kolonave. • Ushtrime për interpretimin e një informacioni në një situatë praktike matematikore. • Etj.
Kompetenca: Zgjidhja e situatës problemore	

Përshkrimi: Vlerësimi i kësaj kompetence do të realizohet nëpërmjet zgjidhjes së situatave problemore të nivelit praktik, të marra nga përvojat e jetës së përditshme apo të nivelit abstrakt, duke vlerësuar zhvillimin intelektual dhe intuitën krijuese të nxënësit.	Llojet e pyetjeve/kërkesave/ushtimeve: • Ushtrime me zëvendësim, zëvendësimi i një zgjidhje me të ngjashmen e saj. • Ushtrime me disa alternativa (përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 alternativat). • Ushtrime me plotësime vendesh bosh. • Ushtrime me përzgjedhje të koncepteve, formulave në zgjidhjen e një situatë problemore. • Ushtrime për të kuptuar situatën e dhënë në një problemë matematikore. • Ushtrime për interpretimin e hapave të ndjekura për zgjidhjen e situatave problemore. • Ushtrime që vlerësojnë vlefshmërinë e zgjidhjes së një situatë problemore. • Ushtrime që paraqesin zgjidhjen e dhënë të një situatë problemore. • Etj.
Kompetenca: Arsyetimi dhe vërtetimi matematik	
Përshkrimi: Vlerësimi i kësaj kompetence do të realizohet nëpërmjet përdorimit të arsytimit dhe argumentimit si aspekte themelore të matematikës. Nxënësi do të vlerësohet për organizimin logjik të fakteve, ideve ose koncepteve, në mënyrë që të arrijë në një rezultat të besueshëm.	Llojet e pyetjeve/kërkesave/ushtimeve: • Ushtrime ku nxënësi ndërton zinxhirin e arsytimeve. • Ushtrime ku kërkohet marrja dhe përzgjedhja e informacionit të duhur nga një situatë e dhënë. • Ushtrime të tipit e saktë /e gabuar. • Ushtrime me bashkimin e elementeve të dy kolonave. • Ushtrime për interpretimin e një informacioni në një situatë praktike matematikore. • Ushtrime që vlerësojnë vlefshmërinë e një argumenti matematikor në një situatë problemore. • Ushtrime ku kërkohet paraqitja e informacionit matematikor.

	• Ushtrime ku përdoret përdorimi i koncepteve matematikore dhe proceseve të përshtatshme për situatën e dhënë. • Ushtrime për zbatimin e koncepteve dhe proceseve në një situatë të dhënë. • Etj.
Kompetenca: Modelimi matematik	
Përshkrimi: Vlerësimi i kësaj kompetence do të bazohet në përshkrimin apo krijimin e modeleve matematikore nga jeta e përditshme.	Llojet e pyetjeve/kërkesave/ushtrimeve: • Ushtrime për paraqitjen e modelimit të një situatë nga jeta reale me gjuhën e matematikës. • Ushtrime për përdorimin e teknikave përkatëse për të gjetur zgjidhjen e përshtatshme matematikore. • Ushtrime për përdorimin e veprimeve themelore të matematikës në situata të jetës së përditshme • Ushtrime që paraqesin dhe “përkthejnë” zgjidhjen matematikore në zgjidhjen e situatës nga jeta reale. • Etj.

V. TABELAT E REZULTATEVE TË TË NXËNIT PËR SECILËN TEMATIKË

Për secilën tematikë, më poshtë paraqiten njohuritë dhe rezultatet e të nxënit, që duhet të demonstrojë nxënësi për të përmbushur kompetencat matematikore. Megjithatë njohuritë përcaktohen për secilën tematikë ato trajtohen të integruara dhe të lidhura me njëra - tjetrën.

1.1 Tematika: Numri

Njohuritë për realizimin e kompetencave matematikore	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave matematikore
BASHKËSITË - Bashkësitë dhe marrëdhënia ndërmjet tyre. - Bashkësitë numerike. - Prerja dhe bashkimi i dy	Nxënësi: BASHKËSITË - përdor simbolet përkatëse, diagramin e Venit, për të paraqitur bashkësitë dhe marrëdhënien ndërmjet tyre; - përdor bashkësitë numerike;

bashkësive. VEPRIMET ME NUMRA - Rradha e veprimeve duke përfshirë kllapat, fuqitë, rrënjët. - Numrat e thjeshtë, faktorë (pjesëtuesit), shumëfishat, faktorët e përbashkët, shvp, pmp; - Fuqitë e numrave pozitivë, si dhe rrënjët përkatëse. - Rrënjët me tregues numër natyror dhe fuqi me eksponentë thyesor. - Numra iracionalë $\sqrt{2}; \sqrt{3}$ etj., dhe π; - Shprehje që përmbajnë rrënjë. THYESAT DHE NUMRAT DHJETORË - Kthimi i numrave dhjetorë të fundmë në thyesë dhe anasjelltas. RAPORTI, PËRPJESËTIMI DHE PËRQINDJA - Raporti si thyesë. - Përpjesëtimi si raporte të barabarta. - Lidhja e raportit me funksionet lineare. - Përqindja si thyesë ose numër dhjetor. - Sasia si përqindje të një sasive	- paraqet me mënyra të ndryshme një interval numerik; - përdor në zbatime prerjen dhe bashkimin e dy bashkësive; VEPRIMET ME NUMRA - zbaton katër veprimet me numrat e plotë, numrat dhjetorë, thyesat (më të vogla dhe më të mëdha se 1), si dhe numrat e përzierë (pozitivë dhe negativë); - përdor radhën e veprimeve duke përfshirë kllapat, fuqitë, rrënjët dhe të anasjellat; - përdor konceptin dhe fjalorin e duhur për numrat e thjeshtë, faktorët (pjesëtuesit), shumëfishat, faktorët e përbashkët, shumëfishat e përbashkët, shumëfishi më i vogël i përbashkët, pjesëtuesi më i madh i përbashkët, faktorët e thjeshtë dhe teoremën e zbërthimit të numrave në faktorë të thjeshtë; - përdor fuqitë e numrave pozitivë, si dhe rrënjët përkatëse (me tregues 2, 3 dhe numra më të mëdhenj), njeh disa fuqi të para të numrave 2,3,4,5; - njehson rrënjët me tregues numër natyror dhe fuqi me eksponent thyesor; - kryen veprime me thyesa, me numra iracionalë $\sqrt{2}; \sqrt{3}$ etj., dhe me π; - thjeshton shprehje që përmbajnë rrënjë (p.sh., $\sqrt{12} = \sqrt{4 \times 3} = \sqrt{4} \times \sqrt{3} = 2\sqrt{3}$) dhe zhdruk rrënjën nga emëruesi (p.sh., $\frac{4}{\sqrt{3}} = \frac{4\sqrt{3}}{3}$); THYESAT DHE NUMRAT DHJETORË - kthen numrat dhjetorë të fundmë në thyesa dhe anasjelltas (p.sh., 3.5 në $\frac{7}{2}$ ose 0.375 në $\frac{3}{8}$); RAPORTI, PËRPJESËTIMI DHE PËRQINDJA - shpreh si raport ose thyesë një marrëdhënie shumëfishiteti ndërmjet dy sasive; - zbaton raportin në situata problemore nga jeta reale (p.sh., ato që përfshijnë këmbimet, krahasimin, ndarjen, përbërjen dhe shkallën); - kupton dhe përdor përpjesëtimin si raporte të barabarta; - lidh raportin me thyesat dhe e shpreh me funksione lineare (p.sh., në një recetë keku: kemi 40g sheqer (y) dhe 50g miell (x), raporti është $4:5 = \frac{4}{5}$. Ekuacioni është $y = \frac{4}{5}x$)
--	---

tjetër. - Interesi i thjeshtë në matematikën financiare. EKSPONENCIALET Fuqitë dhe rrënjët.	- kthen përqindjen në thyesë ose numër dhjetor, duke e interpretuar këtë me shumëfishim; - shpreh një sasi si përqindje të një sasive tjetër; - krahason dy sasi duke përdorur përqindjen; - punon me përqindje më të mëdha se 100%; - zgjidh situata problemore me përqindje, me rritje dhe me ulje të vlerës në përqindje, duke përfshirë edhe interesin e thjeshtë në matematikën financiare; EKSPONENCIALET Nxënësi: - kupton dhe përdor rregullat e fuqive me eksponentë racionalë; - përdor rrënjët duke kryer veprime edhe me rrënjën në emërues;
---	--

1.2 Tematika: Matja

Njohuritë për realizimin e kompetencave matematikore	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave matematikore
MATJET DHE SAKTËSIA E TYRE - Këmbimi i njësive standarde përfshirë njësitë e përbëra. - Shkalla e zmadhimit (zvogëlimit) dhe hartat. MATJE DHE NJEHSIME - Njësitë e matjes dhe konceptet përkatëse (gjatësi, syprinë, vëllim, masë, kohë, para etj.). - Perimetri i figurave plane të përbëra. - Syprina e trekëndëshit, e paralelogramit, e trapezit, rrethit. - Gjatësia e harkut, këndet dhe syprina e sektorit rrethor. - Vëllimi i kuboideve, i prizmit të drejtë, i cilindrit. - Syprina e përgjithshme dhe vëllimi i	Nxënësi: MATJET DHE SAKTËSIA E TYRE - këmben njësitë standarde (p.sh., koha, gjatësia, syprina, vëllimi, masa); - njehson njësitë e përbëra (p.sh; shpejtësinë, normat e pagave, njësitë e çmimeve, densitetin, tensionin) në kontekste numerike dhe algjebrike; - përdor shkallën e zmadhimit (zvogëlimit) dhe hartat; MATJE DHE NJEHSIME - përdor njësitë e matjes dhe konceptet përkatëse (gjatësi, syprinë, vëllim, masë, kohë para etj.); - përdor njësitë e përbëra si shpejtësinë, normat e rrogave, njësitë e çmimeve, densitetin dhe trysinë; - njehson perimetrin e figurave plane të përbëra; - zbaton formula për të njehsuar syprinën e trekëndëshit, paralelogramit, trapezit, rrethit; - njehson gjatësinë e harkut, këndet dhe syprinën e sektorit qarkor;

sferës, piramidës, konit dhe trupave gjeometrikë të përbërë. - Kongruenca dhe ngjashmëria e figurave. - Teorema e Pitagorës, teoremat e Euklidit VEKTORËT - Mbledhja dhe zbritja e vektorëve. - Shumëzimi i vektorëve me një numër. - Paraqitja e vektorit gjeometrikisht dhe në shtyllë me anë të koordinatave. - Vektorët me dy koordinata. - Paraqitja algjebrike e mbledhjes së vektorëve si dhe e shumëzimit të vektorit me një numër. - Largesat ndërmjet dy pikave. TRIGONOMETRI - Koncepti i sinusit, kosinusit, tangjentit dhe kotangjentit. - Teorema e sinusit dhe teorema e kosinusit në trekëndësh. - Formula themelore e trigonometrisë.	- njehson vëllimin e kuboideve, prizmit të drejtë, i cilindrit; - njehson syprinën e përgjithshme dhe vëllimin e sferës, piramidës, konit dhe trupave gjeometrikë të përbërë; - zbaton konceptet e kongruencës dhe ngjashmërisë, përfshirë marrëdhënien ndërmjet gjatësive, syprinës së figurave të ngjashme; - zbaton teoremën e Pitagorës, teoremat e Euklidit; VEKTORËT - zbaton mbledhjen dhe zbritjen e vektorëve, shumëzimin e vektorëve me një numër, paraqitjen gjeometrikisht të vektorit, si dhe paraqitjen me shtyllë me anë të koordinatave; - përdor vektorët me dy koordinata; - paraqet në mënyrë algjebrike mbledhjen e vektorëve, si dhe shumëzimin e vektorit me një numër; - njehson largesën ndërmjet dy pikave; TRIGONOMETRI Nxënësi: - përdor konceptet e sinusit, kosinusit, tangjentit dhe kotangjentit dhe formulat trigonometrike bazë në trekëndëshin kënddrejtë (sinus, kosinus dhe tangjent); - zbaton teoremën e sinusit dhe teoremën e kosinusit në trekëndëshin e çfarëdoshëm për të gjetur gjatësi dhe kënde; - përdor formulën themelore të trigonometrisë $\sin^2 \alpha + \cos^2 \alpha = 1$;
---	---

1.3 Tematika: Gjeometria

Njohuritë për realizimin e kompetencave matematikore	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave matematikore
GJEOMETRIA NË PLAN - Kuptimi i largesës së pikës nga një drejtëz. - Vetitë e këndeve me kulm të përbashkët: shtuese, plotësuese, kënde të kundërt në kulm etj.	Nxënësi: GJEOMETRIA NË PLAN - përdor termat dhe simbolet përkatëse: pikë, drejtëz, kulm, brinjë, plane, drejtëza paralele, drejtëza pingule, kënde të drejtë, shumëkëndështa, shumëkëndështa të rregullt, shumëkëndështa me drejtëza simetrie dhe/ose boshte rrotullimi;

- Këndet korresponduese që formohen nga drejtëza paralele. - Kongruenca e trekëndëshave të çfarëdoshëm (BKB, KBK, BBB) dhe trekëndëshave kënddrejtë. - Kriteret bazë të ngjashmërisë së trekëndëshave. - Vetitë e trekëndëshit dybrinjëshëm. - Ekuacioni i drejtëzës në plan. - Kushti i paralelizmit dhe i pingultisë së dy drejtëzave.	- njeh konceptin e largesës së pikës nga një drejtëz; - zbaton vetitë e këndeve me kulm të përbashkët: shtuese, plotësuese, kënde të kundërt në kulm etj.; - kupton dhe përdor këndet korresponduese që formohen nga drejtëza paralele; - përdor kriteret bazë të kongruencës së trekëndëshave të çfarëdoshëm (BKB, KBK, BBB) dhe trekëndëshave kënddrejtë; - përdor kriteret bazë të ngjashmërisë së trekëndëshave; - identifikon dhe zbaton përkufizimin e rrethit dhe disa veti përkatëse, përfshirë: qendrën, rrezen, kordën, diametrin, perimetrin, tangjenten, harkun, sektorin; - provon dhe zbaton teoremat e rrethit që i referohen këndeve, rrezes, tangjentes, kordave dhe i përdor ato për të zgjidhur situata problemore; - përdor vetitë e mëposhtme: ▪ këndi rrethor që mbështetet mbi diametër është kënd i drejtë; ▪ pingulja e hequr nga qendra mbi kordë është përmesore e kordës; ▪ rrezja e rrethit është pingule me tangjenten e rrethit në pikën ku kalon tangjentja; - paraqet ekuacionin e përgjithshëm të rrethit në trajtë kanonike për të gjetur qendrën dhe rrezen e tij; - përdor ekuacionin e drejtëzës, përfshirë trajtat $y - y_1 = k(x - x_1)$ dhe $ax + by + c = 0$; - interpreton kushtin e paralelizmit dhe të pingultisë së dy drejtëzave; SHNDËRRIME GJEOMETRIKE - identifikon, përshkruan dhe ndërton figura kongruente dhe të ngjashme nëpërmjet simetrisë, zhvendosjes paralele dhe zmadhimit, duke i konsideruar ato edhe në plan koordinativ; GJEOMETRIA NË HAPËSIRË - dallon dhe përdor vetitë e faqeve, brinjëve, kulmeve, syprinave të: kubit, kuboidit, prizmit, cilindrit, piramidës, konit dhe sferës;
---	---

1.4 Tematika: Algjebra dhe funksioni

Njohuritë për realizimin e kompetencave matematikore	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave matematikore
SIMBOLET, VEPRIME ALGJEBRIKE DHE FUNKSIONI - Zëvendësimi i vlerave numerike në formula dhe shprehje algjebrike. - Paraqitja në mënyrë më të thjeshtë e shprehjeve algjebrike. - Shndërrime të njëvlershme në shprehjet algjebrike. - Funksione me të dhëna (bashkësia e përcaktimit) dhe rezultate (bashkësia e vlerave). GRAFIKËT - Grafiku i ekuacioneve lineare në planin koordinativ. - Trajta $y = kx + t$ për identifikimin e drejtëzave paralele dhe pingule. - Ekuacioni i drejtëzës që kalon nëpër dy pika ose që kalon nga një pikë dhe me koeficient këndor (pjerrësi) të dhënë. - Koeficientët këndorë dhe pikëprerjet me boshtet koordinativë të funksioneve lineare. - Rrënjët dhe koordinatat e kulmit të grafikut të funksionit të fuqisë së dytë. - Grafikë të funksioneve lineare, të funksioneve fuqisë së dytë, të funksionit përpjestimor të zhdrejtë $y = \frac{1}{x}$ me $x \neq 0$, - Ekuacioni i rrethit me qendër në origjinën e boshteve koordinative.	Nxënësi: SIMBOLET, VEPRIME ALGJEBRIKE DHE FUNKSIONI - zëvendëson vlerat numerike në formula dhe shprehje duke përfshirë edhe formula nga shkenca të tjera; - paraqet në mënyrë më të thjeshtë shprehjet algjebrike (përfshirë edhe shprehjet me numra irracionalë dhe thyestat algjebrike) duke: - mbledhur kufizat e ngjashme; - shumëzuar një kufizë me një kllapë; - faktorizuar kufizat e përbashkëta; - zbërthyer prodhimet e dy ose më shumë binomeve; - faktorizuar shprehjet e fuqisë së dytë të trajtës $ax^2 + bx + c$; - thjeshtuar shprehjet përfshirë shumën, prodhimin, fuqitë dhe vetitë e tyre; - kupton ndryshimin ndërmjet ekuacionit dhe identitetit; - argumenton matematikisht shndërrime të njëvlershme në shprehje algjebrike; - interpreton shprehje të thjeshta si funksione me të dhëna (bashkësi përcaktimi) dhe rezultate (bashkësi vlerash); GRAFIKËT - ndërton grafikët e ekuacioneve lineare në planin koordinativ; - përdor trajtën $y = kx + t$ për të identifikuar drejtëzat paralele dhe pingule; - gjen ekuacionin e drejtëzës që kalon nëpër dy pika, ose që kalon nga një pikë e dhënë dhe me koeficient këndor (pjerrësi) të dhënë; - identifikon dhe interpreton në mënyrë grafike dhe algjebrike koeficientet këndore dhe pikëprerjet me boshtet koordinative të funksioneve lineare; - gjen në mënyrë algjebrike rrënjët dhe koordinatat e kulmit të

- Ekuacioni i tangjentes së një rrethi në një pikë të dhënë. - Ekuacione dhe grafikë që përshkruajnë përpjesëtimin e drejtë dhe të zhdrejtë. - Pjerrësia e grafikut të një vijë të drejtë si normë ndryshimi. - Koeficienti këndor (pjerrësia) i tangjentes në një pikë të një vije të lakuar (si normë ndryshimi në atë pikë).	- grafikut të funksionit të fuqisë së dytë; - ndërton dhe interpreton grafikë të funksioneve lineare, të funksioneve të fuqisë së dytë, të funksionit përpjesëtimor të zhdrejtë $y = \frac{1}{x}$ me $x \neq 0$; - skicon zhvendosjen paralele dhe simetritë e grafikut të një funksioni të dhënë; - vizaton dhe interpreton grafikët (përfshirë grafikët e funksioneve përpjesëtimore të zhdrejtë, grafikun e funksionit eksponencial) dhe grafikë të funksioneve jo elementare; - përdor ekuacionin e rrethit me qendër në origjinën e boshteve koordinative; - gjen ekuacionin e tangjentes së një rrethi në një pikë të dhënë; - ndërton dhe interpreton ekuacione që përshkruajnë përpjesëtimin e drejtë dhe të zhdrejtë; - interpreton koeficientin këndor (pjerrësinë) të tangjentes në një pikë të një vije të lakuar (si normë ndryshimi në atë pikë);
ZGJIDHJA E EKUACIONEVE DHE E INEKUACIONEVE	ZGJIDHJA E EKUACIONEVE DHE INEKUACIONEVE
- Ekuacione lineare me një ndryshore (përfshirë ekuacionet me ndryshore në të dyja anët e barazimit). - Ekuacione të fuqisë së dytë, duke përdorur formulën përkatëse. - Grafiku i ekuacioneve të fuqisë së dytë. - Sistemi i dy ekuacioneve me dy ndryshore (dy ekuacione lineare). - Zgjidhja grafike e sistemit. - Inekuacione lineare me një ose dy ndryshore. - Bashkësia e zgjidhjeve në boshtin numerik duke përdorur simbolet e bashkësisë dhe grafikë. - Zgjidhja në mënyrë grafike e inekuacionit të trajtës $y > x + 1$ - Zgjidhja e ekuacionit të trajtës $a^x = b$;	- zgjidh në mënyrë algjebrike ekuacione lineare me një ndryshore (përfshirë ato ekuacione me ndryshore në të dyja anët e barazimit); - zgjidh në mënyrë algjebrike ekuacione të fuqisë së dytë, duke përdorur formulën përkatëse; - gjen zgjidhje të përafërta duke përdorur grafikun e ekuacioneve të fuqisë së dytë; - zgjidh në mënyrë algjebrike sistemin e dy ekuacioneve me dy ndryshore; - zgjidh inekuacione lineare me një ose dy ndryshore; - paraqet bashkësinë e zgjidhjeve në boshtin numerik, përdor simbolet e bashkësisë dhe grafikë; - interpreton grafikisht zgjidhjet algjebrike të ekuacioneve; - përdor pikat e prerjeve të grafikëve për të zgjidhur ekuacionet; - zgjidh ekuacione të trajtës $a^x = b$;
VARGJET - Vargu sipas rregullës së kufizave të njëpasnjëshme dhe rregullës kufizë –vend. - Vargjet e numrave trekëndorë, katrorë dhe kubikë.	

- Progresionet e thjeshta aritmetike, progresione të thjeshta gjeometrike. - Vargjet Fibonacci, vargjet e fuqisë së dytë (duke llogaritur diferencën e dytë). - Kufiza e n-të në vargjet lineare. POLINOME DHE FUNKSIONE - Dallori i polinomit të fuqisë së dytë. - Funksionet kuadratike dhe grafikët e tyre. - Funksionet përpjesëtimore dhe grafikët e tyre. - Funksionet e sinusit, kosinusit dhe grafikët e tyre. - Funkzioni $y = e^x$ dhe grafiku i tij. DERIVATI - Koncepti i derivatit të funksionit $f(x)$ si koeficient këndor i tangjentes ndaj grafikut të funksionit $y = f(x)$ në një pikë të çfarëdoshme $(x;y)$. - Derivati si normë (shkallë) ndryshimi. - Zbatime të derivatit për të gjetur koeficientin këndor, ekuacionin e tangjentes dhe pingules së një vije në një pikë të dhënë. - Ekstremumet e funksionit me anë të derivatit.	VARGJET - përfiton kufiza të një vargu sipas rregullës së kufizave të njëpasnjëshme dhe rregullës kufizë-vend; - përdor progresionet e thjeshta aritmetike, vargjet Fibonacci, vargjet e fuqisë së dytë (duke llogaritur diferencën e dytë) dhe progresione të thjeshta gjeometrike; - llogarit kufizën e n-të në vargjet lineare; POLINOME DHE FUNKSIONE Nxënësi: - analizon dallorin e një polinomi të fuqisë së dytë duke përfshirë kushtet për rrënjët dhe rrënjën e dyfishtë; - përdor funksionet kuadratike dhe grafikët e tyre; - kupton dhe përdor funksione përpjesëtimore dhe grafikët e tyre; - përdor funksionet e sinusit, kosinusit, interpreton grafikët e tyre, simetrinë dhe periodicitetin; - njeh dhe përdor funksionin $y = e^x$ dhe grafikun e tij; DERIVATI - kupton dhe përdor derivatin e funksionit $f(x)$ si koeficient këndor të tangjentes ndaj grafikut të funksionit $y = f(x)$ në një pikë të çfarëdoshme $(x;y)$; - interpreton derivatin si normë (shkallë) ndryshimi; - kupton dhe përdor derivatin e dytë si normë (shkallë) ndryshimi të derivatit të parë; - zbaton derivatin për të gjetur koeficientin këndor, ekuacionin e tangjentes dhe pingules së një vije në një pikë të dhënë; - përcakton ekstremumet e funksionit me anë të derivatit.
--	---

1.5 Tematika: Statistika dhe probabiliteti

Njohuritë për realizimin e kompetencave matematikore	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave matematikore
STATISTIKË - Popullata dhe kampionimi. - Tabela, diagrame, tabela dendurie,	Nxënësi: STATISTIKË - nxjerr të dhëna për popullatën ose shpërndarjen nga një kampion,

diagrami rrethor për të kategorizuar të dhëna. - Diagrami me shtylla për të paraqitur të dhëna numerike diskrete jo të grupuara. - Mesataret (mesorja, mesatarja aritmetike, moda dhe klasa modale), amplituda. PROBABILITETI - Denduritë e rezultateve në eksperimente probabilitare duke përdorur tabelat dhe pemën e dendurive. - Ngjarjet e rastit, njëlloj të mundshme dhe të pavarura, për të njehsuar rezultatet e pritshme nga eksperimentet. - Shuma e probabiliteteve të të gjitha ngjarjeve elementare është një. - Shuma e probabiliteteve të ngjarjeve dy e nga dy të papajtueshme, bashkimi i të cilave jep hapësirën e rezultateve, është një. - Hapësira e rezultateve të mundshme teorike për eksperimente të veçanta ose për eksperimente të përbëra me rezultate njësoj të mundshme. - Probabiliteti i ngjarjeve të kombinuara, të varura dhe të pavarura.	ndërkohë që njëh kufijtë e kampionimit; - përdor dhe kupton teknikat e zgjedhjes statistikore përfshirë zgjedhjen e rastit të thjeshtë dhe zgjedhjen e kampionit; - interpreton dhe ndërton tabela, diagrame, përfshirë edhe tabela dendurie, diagrame rrethore për të kategorizuar të dhëna, diagrame me shtylla për të paraqitur të dhëna numerike diskrete jo të grupuara, si dhe njëh përdorimin e tyre në mënyrë të përshtatshme; - ndërton dhe interpreton diagrame për të paraqitur të dhëna diskrete të grupuara dhe të dhëna të vazhduara, p.sh., histograme me intervale klasash të barabarta dhe jo të barabarta, si dhe grafikë dendurie të grumbulluar duke njohur përdorimin e tyre në mënyrë të përshtatshme; - interpreton, analizon dhe krahason shpërndarjen e të dhënave me shpërndarjet empirike me një ndryshore nëpërmjet: - mesatareve (mesorja, mesatarja aritmetike, moda dhe klasa modale); - amplitudës; PROBABILITETI - përshkruan dhe analizon denduritë e rezultateve në eksperimente probabilitare, duke përdorur tabelat dhe pemën e dendurive; - zbaton ngjarjet e rastit njëlloj të mundshme dhe të pavarura për të njehsuar rezultatet e pritshme nga eksperimentet; - zbaton vetinë që shuma e probabiliteteve e të gjitha ngjarjeve elementare, është një; - zbaton vetinë që shuma e probabiliteteve të ngjarjeve dy e nga dy të papajtueshme, bashkimi i të cilave jep hapësirën e rezultateve, është një; - kupton që sa më shumë rritet numri i provave, aq më shumë denduria relative i afrohet vlerës së probabilitetit teorik; - krijon hapësira rezultatesh të mundshme teorike për eksperimente të veçanta ose për eksperimente të përbëra me rezultate njësoj të mundshme dhe i përdor ato për të njehsuar probabilitetin teorik; - njehson probabilitetin e ngjarjeve të kombinuara të varura dhe të pavarura, duke përfshirë diagramin <i>pemë</i> dhe paraqitje të tjera; - njehson dhe interpreton probabilitetin me kusht nëpërmjet paraqitjeve të dendurive me tabela me dy hyrje, me diagramin <i>pemë</i> dhe diagramin e
--	---

	Venit. - njehson probabilitetin e ngjarjeve të pavarura dhe të ngjarjeve të papajtueshme.
--	--